



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 110 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV , me të cilën pretendohet se më datën 29.04.2012, në VV2501X/07R, në Ferizaj, për 10 persona me mbiemër Koxha, ka pas nënshkrime në listën e votuesve edhe pse sipas parashtruesit të ankesës këta persona siç janë theksuar në ankesë me emër e mbiemër gjenden jashtë vendit.

PZAP-i, më datë 02.05.2012, ka kërkuar të gjitha materialet nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve (KQZ), për Vendvotimin 2501X/07R.

PZAP-i, me datën 02.05.2012, ka kërkuar që Kryesuesi i VV 2501X/07R të përgjigjet ndaj ankesës së lartpërmendur Anr.110/2012. Në përgjigjen e Kryesuesit të VV të lartpërmendur thuhet se në VV2501X/07R, nuk ka pas asnje mbiemër që fillon me shkronjën “K”, për të cilën arsyetuar që te hidhen poshtë pretendimet ankimore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, vlerësoi pretendimet ankimore se në VV2501X/07R, në Ferizaj, për 10 persona me mbiemër Koxha, ka pas nënshkrime në listën e votuesve edhe pse sipas parashtruesit të ankesës këta persona gjenden jashtë vendit ndërsa në librin përfundimtar të votuesve kishte nënshkruar ne emrin e tyre kinse dikush tjetër, dhe gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se, në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) në VV 2501X/07R, nuk figuron asnjë person me mbiemër Koxha. Në fakt, në ankesë nuk janë dhënë prova apo dëshmi relevante, të cilat do ti argumentonin pretendimet e tillë ankimore. Andaj duke marr parasysh ketë gjendje të fakteve, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazuar. Për arsyet e dhëna me lartë, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 110 /2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit  
Muhammed Shala

